

RREGULLORE NR. 2001/15

PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 2000/2, TË NDRYSHUAR, MBI AKCIZAT NË KOSOVË

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), të ndryshuar, mbi autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Me shpalljen e Rregullore nr. 2000/2 të datës 22 janar 2000 të UNMIK-ut mbi akcizat në Kosovë, dhe Rregulloreve të UNMIK-ut nr. 2000/26 të datës 27 prill 2000, nr. 2000/35 të datës 16 qershor 2000 dhe nr. 2000/56 të datës 6 tetor 2000, për ndryshimin e Rregullore nr. 2000/2 të UNMIK-ut,

Duke pasur parasysh që neni 2.2 i Rregullore nr. 2000/2 të UNMIK-ut, të ndryshuar, parasheh që mallrat të cilat i nënshtrohen akcizës dhe tarifave në fuqi të akcizës të paraqitura në Shtojcën A,

Me qëllim të ndryshimit të Shtojcës A të Rregullore nr. 2000/2 të UNMIK-ut, të ndryshuar,

Shpall sa vijon:

Neni 1
Ndryshimi

Shtojca A e Rregullore nr. 2000/2 të UNMIK-ut, të ndryshuar, zëvendësohet me Shtojcën A të kësaj Rregulloreje.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më 3 korrik 2001.

Hans Haekkerup
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

SHTOJCA A

MALLRAT QË I NËNSHTROHEN AKCIZAVE DHE TARIFAVE

Përshkrimi i mallrave	Shifra në sistem të harmonizuar	Tarifat e taksës
Kafja	0901	30% të vlerës
Pijet joalkoolike	2202	10% të vlerës
Birra e elbit	2203	0.3 DM për litër
Vera e rrushit të freskët, përfshirë verërat e pasuruara; mushti i rrushit, përveç atij të përfshirë në kreun nr. 20.09 Vermuthi dhe verërat tjera ose rrushi i freskët i aromatizuar me bimë apo substanca aromatik	2204; 2205	0.4 DM për litër
Pijet e tjera të fermentuara (p.sh., sidër (verë molle), raki dardhe, pije alkoolike nga fermentimi i mjaltit); përzierjet e pijeve të fermentuara dhe pijet joalkoolike, të paspecifikuara apo të papërfshira gjetiu	2206	0.3 DM për litër
Etil alkooli i padenatryalizuar i një fortësie alkoolike prej 80 % ose më lartë	2207	2 DM për litër të alkoh.
Etil alkooli i padenatryalizuar i një fortësi më pak se 80 %; pijet alkoolike, likeret dhe pijet e tjera alkoolike	2208	2 DM për litër të alkoh.
Cigaret	2402	4 DM për 1000 cigare
Cigaret puro, cigarilloset dhe prodhimet e tjera të përpunuara të duhanit	2402 2043	50% të vlerës
Benzina	27100026;27100027; 27100029;27100032; 27100034; 27100036	45 fening për litër*
Vaji për djegie	27100066; 27100068	40 fening për litër

Nafta për automjete (D1 + D2)	2710003100	40 fening për litër
Vajguri	2710051; 27100055	40 fening për litër
Vaji për ngrohje	271000 4100; 271004900	40 fening për litër
Telefonat mobil	851719	15% të vlerës
Videotë	8521	15% të vlerës
Aparatet televizive	8528	15% të vlerës
Antenat satelitore	85291031	15% të vlerës
Automobilat dhe automjetet, parimisht të disajnuara për transportimin e personave (pos atyre që hyjnë në radhën nr. 8702), duke përfshirë automobilat e tipit karavan dhe automobilët e garave	8703	20% të vlerës + 1000 DM për secilin

*Kjo tarifë do të rritet për 5 fening më 1 tetor 2001 duke vazhduar me një rritje të mëtejme për 5 fening më 1 janar 2002.